



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 31/1 Prot.

Tiranë, më 24/10/2011

Lënda: Rekomandim për **Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë**.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë**,

KONSTATOVA

Më datë 16/06/2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, **Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë**, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë në aktivitetin e tij grumbullon dhe përpunon të dhëna personale të kategorisë, “pacient” “dhurues vullnetar dhe familjarë”, të dhënat të stafit mjekësor dhe stafit administrativ.

1. U konstatua se , kontrolluesi Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë nuk ka plotësuar të gjitha rubrikat sipas formularit të njoftimit, në përputhje me nenin 21 të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 ”Për Mbrojtjen e te Dhënave Personale”, me mangësitë si poshtë:
 - Kontrolluesi tek **Rubrika 2** nuk ka plotësuar, fushën e veprimtarisë “ institucion shtetëror”;
 - Kontrolluesi tek **Rubrika 5** nuk ka plotësuar nënrubrikën ”nënpunës” dhe atë “pacientë”
 - Kontrolluesi tek **Rubrika 6** nuk ka plotësuar, kategorinë e të dhënave personale, ”Formimi-Diplomat_Medaljet”.
 - Kontrolluesi tek **Rubrika 10** dhe konkretisht, **nënrubrika “Siguria teknike”**, nuk ka plotësuar në kutizat alternative “Jo” ose “Po”, ndërsa kutizat “Data back up copies”, “Fjalëkalim hyrës”, dhe “Antivirus”, që janë në funksion të kësaj nënrubrike, janë plotësuar.
 - Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 ”Për Mbrojtjen e te Dhënave Personale”, “...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë” dhe 23 i ligjit “ Komisioneri shqyrton të gjitha njoftimet dhe kur njoftimi është i pamjaftueshëm, ai urdhëron kontrolluesin të plotësojë të dhënat, duke përcaktuar edhe afatin kohor ”.

2. Kontrolluesi, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, Tiranë, nuk ka një rregullore të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin sipas parashikimeve të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, por ka seksione sporadike në rregulloret ekzistuese të tij, për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

U konstatua se, ky kontrollues përpunon të dhëna personale kryesisht në mënyrë manuale dhe automatike, ndërsa kjo e fundit është në proces e sipër, pasi një sistem i ri është duke u implementuar.

Për dokumentacionin e mbajtur në mënyrë manuale është krijuar arshiva e kontrolluesit, që në këtë rast ndahet në dy ambiente; një ambient ku mbahen të dhënat sensitive për pacientët me sëmundjet infektive, HIV/AIDS, Hepatiti B, Hepatiti C, dhe Sifilisi; ndërsa në ambientin tjetër arkivohen të dhëna të pacientëve, dhuruesve vullnetarë apo familjarë, të cilët nuk janë të prekur nga këto sëmundje infektive. Pas kalimit të një afati të caktuar kohor, në bazë të afateve të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë, këto dosje i nënshtrohen rregullave sipas ligjit të Arkivave. Në bazë të Urdhërit, Nr.2, datë 14.04.2008, të Ministrit të Shëndetësisë, “Për Miratimin e Rregulloreve për zbatimin e skemës së Hemovigjilencës”, dhe nenit 7, të kësaj rregulloreje, **“Mbajtja e të dhënave për gjurmimin”:**”*Të dhënat e paraqitura në **Aneksin 1**, ruhen të paktën për 30 vjet, në një mjedis ruajtës të përshtatshëm dhe të lexueshëm, nga Strukturat transfuzionale dhe ato*

spitalore publike dhe private në mënyrë që të sigurohet gjurmueshmëria e duhur në një moment të caktuar”.

Në bazë të nenit 4, “**Përkufizime**”, të Ligjit Nr.9739, datë 21.05.2007, “Për Shërbimin e Transfuzionit të Gjakut në Republikën e Shqipërisë”, “*Gjurmim*”, është gjaku i plotë i mbledhur nga dhuruesi dhe që përdoret si i tillë për transfuzion ose që përpunohet për të prodhuar produkte të tij”.

Aneksi 1, përfshin Skemën e kartelës së dhuruesit të gjakut/komponentët;

Pjesa A, përmban të dhënat personale të dhuruesit, të cilat janë si më poshtë:

- Emri, Atësia, Mbiemri;
- Vendi dhe data e lindjes;
- Seksi;
- Profesion;
- Vendi i punës;
- Adresa e plotë e banimit;
- Kontakte telefonike;
- Nr. i dokumentit të identifikimit.

Gjithashtu në Pjesën A, është hartuar një pyetësor, të cilin dhuruesi e plotëson si kusht i domosdoshëm për të qënë dhurues.

Në Pjesën B, të Skemës, përfshihet “**Deklarata e dhuruesit**”, i cila deklaron se të dhënat që ai (dhuruesi), ka plotësuar sipas pyetësorit janë të dhënat e tij. Në fakt, kjo deklaratë ndoshta mund të nënkuptojë dhënien e pëlqimit, po nuk është e shprehur qartë ashtu si e kërkon neni 3, pika 12 e Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, “**Pëlqimi**” është deklarata specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij.”

Ambjentet, në të cilat mbahet ky dokumentacion nuk janë sipas të gjithë elementëve të sigurisë ashtu si parashikohet në Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sidomos, kur është fjala për mbrojtjen e të dhënave sensitive.

Dokumentacioni i mbajtur në mënyrë manuale vlen për të dëshiruar. Dokumentacioni i një dhuruesi apo pacienti nuk imbahet në dosje por vetëm me kapëse dhe shumica e tyre gjendeshin në tokë. Mungojnë raftet ku të vendosen dosjet.

Përveç plotësimit manual të kartelave të dhuruesve të gjakut, kontrolluesi realizon dhe regjistrimin elektronik të tyre përmes programi kompjuterik (emri). Përmes një kontrate bashkëpunimi me një kompani vendase programi është përshtatur dhe përkthyer pjesërisht dhe është siguruar një licence përdorimi. Për shkak të kompleksitetit dhe kostos së lartë të licencimit të tij, programi është instaluar prej disa vitesh vetëm në rrjetin e brendshëm të ambienteve qendrore të QKTGJ. Qëllimi kryesor i përdorimit të tij është dixhitalizimi i procesit të regjistrimit të dhuruesve të gjakut dhe personave që kryejnë analiza pranë Qendrës, për të ndihmuar personelin në plotësimin e kartelave, korrigjimin e gabimeve dhe për të realizuar statistika të ndryshme.

Baza e të dhënave të programit ruhet në server në një ambient të veçantë brenda Qendrës. Specialisti që ka mbikëqyrur instalimin, menaxhon dhe aspektin teknik të funksionimit të programit dhe databazës në serverin përkatës. Kopja rezervë e databazës ruhet në server si dhe kasete të veçanta.

Përsa i përket administrimit dhe niveleve të aksesit, si administrator i programit është përcaktuar Drejtoresha e Qendrës. Vetëm përmes llogarisë së Administratorit përcaktohen të gjitha llogaritë e përdoruesve të tjerë dhe nivelet e tyre të aksesit. P.sh. vetëm mjeket e Departamentit të Regjistrimeve mund të plotësojnë kartelat me emrat përkatës, ndërkohë pjesa tjetër e personelit mund të shikonte vetëm të dhënat e kartelës me kodin e saj, jo emrin e personit.

3. Kontrolluesi Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, në kontratën me instaluesin (Firma, "Communication Progres) e sistemit automatik ka parashikuar vetëm procedurat e likuidimit apo plotësimit të afateve kohore mbi instalimin e rrjetit telefonik dhe kompjuterik, por përsa i përket aksesit të instaluesit, në lidhje me të dhënat personale, që instaluesi mund të aksesojë gjatë ushtrimit të detyrës së tij nuk ka të parashikuar asgjë. Për pasojë, nuk janë përcaktuar në një dokument të shkruar, të drejtat dhe detyrimet e palëve, aksesit i kufizuar dhe personat përgjegjës për ndërhyrjet në këtë sistem, çfarë bën që në lidhje me të dhënat e grumbulluara nga ky përpunim, të mos ketë një nivel të përshtatshëm sigurie, për të mbrojtur të dhënat e subjekteve të të dhënave nga përpunimi jo i ligjshëm i tyre nga personat e pautorizuar.

- Në këtë rast nuk zbatohet neni 27, pika 2/ a, b, c, ç , të ligjit nr. 9887, dt 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

"Kontrolluesi merr këto masa të vecanta sigurie:

- a) përcakton funksionet ndërmjet njësive organizative dhe operatorëve për përdorimin e të dhënave;*
- b) përdorimi i të dhënave bëhet me udhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar "*
- c) "udhëzon operatorët pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave",*
- ç) ".....ndalon hyrjen në mjediset e kontrolluesit ose të përpunuesit të të dhënave të personave të paautorizuar".*

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

- 1. Në zbatim të Nenit 21, 22 dhe 23 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" kontrolluesi Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, të riformulojë Formularin e njoftimit duke plotësuar të gjitha mangësitë e konstatuara në pjesën arsyetuese të këtij rekomandimi.**

2. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” kontrolluesi Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, duhet të hartojë rregullore të brendshme (pavarësisht se në rregulloret ekzistuese janë të përfshira seksione sporadike) për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin.

Rregullorja duhet t’ju bëhet e njohur subjekteve të të dhënave, e cila mund të jetë dhe në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut (nëse e kanë ose do ta kenë në të ardhmen). Kjo për faktin se ky kontrollues, jo vetëm është një kontrollues potencial për nga përmasat e grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave, por dhe për faktin se këto të dhëna janë kryesisht sensitive.

Gjithashtu, kontrolluesi Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut në kontratën me instaluesin (Firma Communication Progres) e sistemit automatik duhet të përcaktojë të gjitha detyrimet që kanë në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

3. Në zbatim të nenit 3 pika 12 e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, në “Deklarata e dhuruesit” pëlqimi të përcaktohet specifikisht i qartë në një rubrikë më vehte, pasi subjekti i të dhënave të jetë i informuar për çdo aspekt të përpunimit të të dhënave të tij para se pëlqimi të jetë dhënë.

4. Kontrolluesi, Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut, të marrë masa në lidhje me krijimin e kushteve për mirëmbajtjen e dokumentacionit nëpër dosje dhe sistemimin e dosjeve sipas problematikës.

Të zbatohet Udhëzimit nr. 5, datë 26/05/2010 “ Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor” të Komisionerit Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI
FLORA CABEJ (POGAÇE)

